

Agjencia realizoi takimin e tretë publik për vitin 2019

✘ **Shkup, 24 shtator 2019** – Sot, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele realizoi takimin e tretë publik për vitin 2019. Drejtori i Agjencisë, d-r Zoran Trajčevski, në fjalimin hyrës i prezantoi aktivitetet e realizuara për tremujorin e tretë, sipas Programit vjetor për punën e Agjencisë mbikëqyrjet të realizuara ndaj radiodifuzerëve, publikuesit e medimeve të shtypit dhe operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik, masat e shqiptuara të vërejtjes, analizat e përpunuara, aktivitetet në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Të pranishmit kishin mundësi që të përcjellin edhe ✘ konstatimet kyçe të Analizës së tregut për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në vitin 2019 në të cilën janë përfshirë puna ekonomike e servisit radiodifuziv publik si dhe televizioneve dhe radiove komerciale, si dhe të dhënat nga matja e publikut të televizionit dhe radios. Analizën të cilën e punoi Agjencia tregoi se të hyrat në e përgjithshme në industrinë mediatike audio dhe audiovizuele, nga viti në vit janë në rënie. Sipas të dhënave, të hyrat e përgjithshme që bashkarisht i kanë realizuar radiodifuzerët në vitin 2018 është 2.451,65 milion denarë, krahasuar me vitin 2017, shënojnë rënie prej 6,03% dhe njëkohësisht janë të hyra më të ulëta në pesë vitet e fundit.

Në takim u promovuan edhe infografite për arsimim mediatik – Pas titujve dhe Pas „lajmeve të rejshe“, të cilat në format origjinal në gjuhën angleze punoi organiaata ndërkombëtare EAVI. Në njërin infografik janë treguar drejtime për identifikimin e llojeve e lajmeve të rejshe, si që janë lajme me mashtrime për klikime , përmbajtje të sponsorizuara, propagandë, dezinformata, të paramenduara dhe të ngjajshme. Në infografitin e dytë është paraqitur lojë me përmbajtje

edukative dedikuar për kontrollimine lajmeve në internet – data valide e publikimit të përmbajtjes, a janë identifikuar autorët ose shfrytëzohen me psoudonime dhe ngjajshëm. Me qëllim aë të kenë qasje te një numër më të madh i qytetarëve, Agjencia i shtypi në gjuhën maqedone dhe gjuhën shqipe.

Prezantimet nga takimi i tretë publik mund të merren në këto linke:

- **Aktivitetet e realizuar sipas Programit vjetor për punën e Agjencisë – tremujori i tretë i vitit 2018**

d-r Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë

- **Pas titujve dhe “lajmeve të rejshme” prezantime të infografikëve për arsimim mediatik**

Infografike për arsimim mediatik

- **PASTITUJVE lojë për identifikimin e lajmeve në internet – PAS LAJMEVE TË REJSHME 10 lloje të lajmeve të rejshme**

Mr – Sasho Bogdanovski, Sektori për çështje programore

- **Analiza e tregut të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele për vitin 2018**

Sanja G. Zdravkova, Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit